



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_098_2008
Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_93_06_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-ë: ZRRE/DMK_R_93_06_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Shyqëri Krasniqi (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90025738) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të datës 06 maj 2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 16 maj 2008, lidhur me gjobat për njoftimin për shkyçje dhe gjobat shkyçje.
2. Me datë 13 mars 2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar gjobat për njoftime për shkyçje dhe gjobat për shkyçje.
3. Departamenti për Konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se njoftimet për shkyçje dhe shkyçjet e realizuara nga ana e KEK-ut kanë ndodhur për shkak të borxhit që konsumatori ka pas ndaj KEK-ut. Në përgjigjen e KEK-ut janë theksuar edhe datat e shkyçjes së parë, të dytë si dhe gjobat për shkyçje. Të njëjtën përgjigje KEK-u ja ka dhënë konsumatorit edhe me datë 16 maj 2008, duke plotësuar përgjigjen me shpjegime për bazës ligjore sipas së cilës është ngarkuar konsumatori.
Provë: Përgjigja e KEK-ut me nr. reference DPR – CO1 – 14.
4. Me datë 06 maj 2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.



5. Me datë 01 korrik 2005 konsumatori ka nënshkruar me KEK-un Kontratën për rregullimin e borxhit, ku shuma e borxhit të riprogramuar është 437.30 € ndërsa këstet mujore kanë qenë 22.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
6. Me datë 07 nëntor 2005 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 461.70 € (plus edhe pjesën tjetër të mbetur të KRRB).
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
7. Me datë 30 mars 2006 KEK- u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 599.44 € (plus edhe pjesën tjetër të mbetur të KRRB).
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
8. Me datë 25 prill 2006 punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
9. Me datë 04 maj 2006 punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes tek konsumatori kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur në rrjetin elektrik pa lejen e KEK-ut dhe se për shkak të këtij veprimi punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje sërish e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
10. Me datë 29 nëntor 2006 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 1067.07 €.
Provë: Ngarkesa për njoftim për shkyçje në kartelën e transaksioneve të konsumatorit
11. Me datë 06 janar 2007 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatori deri në atë kohë ka qenë 834.93 €.
Provë: Ngarkesa për njoftim për shkyçje në kartelën e transaksioneve të konsumatorit.
12. Me datë 02 mars 2007 punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut, konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
13. DMK e ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori i **rekomandon** Bordit të ZRRE-së që të **refuzohet** ankesa e konsumatorit në arsyetimin se:



- 13.1** KEK-u ka respektuar procedurat, rregulloret dhe ligjet në fuqi, përveç në dy raste të dërgimit të njoftimeve për shkyçje tek konsumatori me datë 30 mars 2006 dhe ajo 06 janar 2007.
- 13.2** Të gjitha njoftimet për shkyçje, shkyçjet dhe rikyçjet e konsumatorit janë bërë sipas rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë
- 13.3** Sipas nenit 4.7 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ndërmarrja e energjisë ka të drejtë të ngarkoj me një taksë konsumatorin për përgatitjen e njoftimeve të shkyçjes, si dhe me taksë për realizimin e shkyçjes dhe rikyçjes sipas Shtojcës 1: Tabela e Çmimeve dhe Gjobave të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve
- 13.5** KEK-u duhet ta shkarkoi kartelën e konsumatorit për ngarkesën që i është bërë për dy njoftimet për shkyçje të datës 30 mars 2006 dhe 06 janar 2007, këto dy njoftime KEK-u nuk ka pas nevojë ti dërgoi pasi që është dashur ti referohet njoftimeve për shkyçje të dërguara më herët të datës 07 nëntor 2005 gjegjësisht të datës 29 shtator 2006.
- 13.5** Konsumatori ka kërkuar që ZRRE të marrë parasysh rrethanat të cilat e kanë shtyrë konsumatorin që të bëjë rikyçje pa pëlqimin e KEK-ut, por ZRRE nuk ka mandat që të lirojë ndonjë konsumator nga obligimet financiare me të cilat e ka ngarkuar KEK-u, nëse KEK-u nuk ka bërë ndonjë shkelje të kornizës ligjore në fuqi. ZRRE mirëkupton dhe respekton dëshmorët e familjes së konsumatorit, por njëkohësisht shpreh keqardhje se mandati ligjor nuk lejon lirimin e konsumatorit prej obligimeve që i ka ndaj KEK-ut. Janë organet gjyqësore ato të cilat mund të marrin parasysh rrethanat lehtësuese për konsumatorin.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që të refuzojë ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në rekomandimin e DMK në ZRRE.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, Kryesues

Mr. Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU